



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **13 mars 2026, (e premte)**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**.

Kryesuesi: Fillimisht, besoj që materialin e keni pranuar! Atëherë, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar komunës, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, kabinetin e kryetarit, kabinetin tim, si dhe asistenten e kryesuesit.

E hapim mbledhjen e **dytë (2)** për këtë vit kalendarik. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë P-00214-1, ZK-Zoqisht;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00214-1, ZK-Zoqisht;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P--02240-80 në zonën kadastrale Rahovec;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 31/25, të datës 28.3.2025, për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 50/25, të datës 29.4.2025, “Park Hotel Plaza”, Rahovec;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katrorë);
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katror), P-00413-2 ZK-Rahovec;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026;
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qendrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Rahovecit 2026 – 2028;
11. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025-2026;
12. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2025;
13. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush ka diçka rreth rendit të ditës?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Të nderuar drejtorë, nënkryetarë, kolegë anëtarë të KPF-së, qytetarë. Rëndin e ditës e kemi pranuar. Në mbledhjen që e kemi pasur për hartimin e planit të punës së kuvendit, në muajin mars e kemi formimin e dy komiteteve jo-obligative: Komitetin për Shërbime Publike dhe Komitetin për Emergjencë. Në muajin prill, sipas planit të punës duhet të vazhdojmë me formimin e dy komiteteve të tjera: Komitetin për Shëndetësi dhe Komitetin për Arsim. Kërkoj që për mbledhjen e radhës të formohen dy komitetet e parapara me plan të punës.

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigzon! Ne do t'ja përcjellim ekzekutivit dhe në seancën e kuvendit ta kemi një vendim. Nuk e di sa mund të jetë e mundshme, për shkak të afatit kohor të shpandarjes së materialit, por si pikë e rendit të ditës është e paraparë dhe me mirëkuptim këto dy pika të rendit të ditës. Po e vendosim në votim rendin e ditës. Kush është "për"?... A ka votë kundër?... Unanimisht miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi diçka rreth procesverbalit?... Nëse jo, po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht miratohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, P-00214-1, ZK-Zoqisht:

Besmire Bytyqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së. Para jush e keni propozim vendimin për miratimin e dhënies së pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme prej 15-99 vjet. Kjo pikë bëhet përmes procedurës së shprehjes së interesit. Parcela është në zonën kadastrale në Zoqisht në sipërfaqe prej 173m² e që ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3658m². Qëllimi: Rritja dhe ruajtja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin e aktivitetit biznesor në mënyrë që t'u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen. Afati kohor i dhënies në shfrytëzim është afatgjatë – në periudhë prej 40 vjetësh.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtoreshë! Kërkoj nga ju që në seancën e rregullt të kuvendit, pika e rendit të ditës t'i paraqitni me ortofoto, në mënyrë që secili kuvendarë ta shoh vendin e sakt se ku gjendet parcela. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00214-1, ZK-Zoqisht:

Besmire Bytyqi: Pika e radhës është për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të parcelës që e votuam paraprakisht. Ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga legjislativi dhe 1 përfaqësues nga sektori joqeveritar.

Lirigzon Kastrati: Drejtoreshë, momentalisht çka është e ndërtuar në këtë parcelë?

Besmire Bytyqi: Në të njëjtën parcelë është një ndërtim, por që nuk shfrytëzohet. Ne po kërkojmë që ta japim në shfrytëzim në mënyrë që kësaj prone në Zoqisht t'i rritet vlera, duke mos e ndryshuar asnjëherë pronarin e parcelës (Komuna e Rahovecit).

Kryesuesi: Faleminderit, drejtoreshë! Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës, P- 02240-80 në zonën kadastrale Rahovec:

Besmire Bytyqi: Para jush e keni propozimin për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelës 02240-80, në zonën kadastrale Rahovec. Po kërkojmë që ta shpallim me interes të përgjithshëm sipërfaqen prej 9900m² dhe që ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7.512.400m². Kjo parcelë është në vendin e quajtur "Shum kabilja glava" dhe sipas certifikatës së pronësisë është pronë e Kosovës – pyjet. Qëllimi: Është fillimi i procedurave së këmbimit të pronës

komunale me pronën e institucionit qëndror për ndërtimin e kalasë, për nder të rënies së dëshmorit të kombit, Xhevdet Qazim Morina. Kjo parcelë gjendet te pjesa kur e kalon Zatriqin, rrugës për Malishevë në anën e majtë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtoreshë! Po e hapim debatin? Nëse nuk ka diskutues, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e katërt e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 31/25, të datës 28.3.2025, për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 50/25, të datës 29.4.2025, “Park Hotel Plaza”, Rahovec:

Altin Zhuniqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive dhe anëtarë të KPF-së. Para jush e kemi propozim-vendimin për ndryshimin e vendimit 01 Nr. 31/25, të datës 28.3.2025, për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 50/25, të datës 29.4.2025. Përveç pikave të tjera që janë ndryshuar dhe plotësuar në këtë vendim, shtohet edhe ndryshimi te pika e katërt. Ndryshimi duhet të jetë çmimi fillestar i pronës komunale, i cekur në pikën 1 dhe 2 të vendimit bazik i caktuar nga komisioni për vlerësimin e ofertave.

Lirigzon Kastrati: Ne e kemi vendimin që ndryshimi duhet të ndodhë në pikën 5, apo jo? Do të thotë në seancë do ta kemi vendimin e ndryshuar.

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigzon! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katrorë):

Altin Zhuniqi: Para jush e kemi propozimin-vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m². Qëllimi: Ruajtja edhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin e aktiviteteve biznesore. Lokaliteti iu ka shkëputur kontrata, sepse nuk ka qenë i rregullt me pagesa të qerasë. Lokali gjendet te rruga “Avdullah Bugari”, prej semaforëve rrugës për te Keds-i.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse nuk ka diskutues, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokalit nr. 36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 30m² (tridhjetë metra katror), P-00413-2, ZK-Rahovec:

Altin Zhuniqi: Në këtë pikë kërkojmë ta formojmë komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Bëhet fjalë për të njëjtin lokal, nr.36.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së. Drejtorja për Buxhet dhe Financa e ka përgatitur dokumentin mbi bartjen e mjeteve nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026. Shuma që do të bartet është prej 621.000€. Në bazë të kësaj vlere e kemi përgatitur një dokument tjetër në formë tabelare, duke i futur edhe disa projekte të reja kapitale, të cilat kanë dalur sipas planit të prokurimit të përgatitur në dhjetor. I kemi edhe 5 projekte që janë në vazhdim dhe kemi menduar t'i zbusim obligimet kontraktuale që i kemi në kuadër të këtyre projekteve. Dje, në ora 15:55 më ka ardhur në email nga Departamenti i Thesarit që paska ndryshuar edhe ligji. Me këtë ndryshim nuk kemi të drejtë të shtojmë projekte të reja, por mjetet t'i bartim në kuadër të projekteve ekzistuese, të cilat janë në vitin 2025 dhe

në projektet e vitit 2026. Andaj, detyrohemi t'i tërheqim këto dokumente, në të cilat janë 6 projekte me vlerë 250.000€. Fatbardhësisht, emaili ka ardhur para mbledhjes së KPF-së, sepse përndryshe ndoshta do të kishim telashe. Kjo shumë prej 250.000€ duhet të bartet në projektet që janë në listën e vitit 2025, prej shumës totale 621.339€.

Lirigzon Kastrati: Drejtori e potencoi që tani do të hiqen këto 6 projektet që janë në tabelë, në vlerë 250.000€. Këto mjete, a do të shpërndahen në këto kategori që janë brenda prezantimit, apo do t'i vendosni në projektet e tjera ekzistuese? Këtu po e shoh këtu që disa mjete janë ndarë edhe për shtratin e lumit që i lidh disa fshatra.

Berat Duraku: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë. Fillimisht, e falënderoj drejtorin dhe shërbyesit civilë, që janë angazhuar në mbledhjen e të hyrave me këtë shumë që është grumbulluar, e cila do të shpërndahet në projekte kapitale. Drejtor, a lejohet t'i vendosim në kategori: P.sh: Siç është kodi për mallra dhe shërbime që është një pjesë që do të barten, po e zëmë te pjesa e subvencioneve, nëse është fjala për sistemin e ujitjes nga burimet alternative, a do të lejohet që t'i vendosim në kategorinë e subvencioneve dhe ky projekt të mund të zbatohet prej kësaj kategorie?

Afrim Limani: Lirigzon, pyetje me vend. Këtë vlerë do e vendosja në kuadër të këtyre projekteve ekzistuese. Na e kemi edhe kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe komunalit. Mos të harrojmë, vitin e kaluar Drejtorja e Shëndetësisë që nga muaji gusht nuk e ka pasur asnjë cent. Thesari për shkak të kontratës kolektive, përmes përmbaruesit i ka tërhequr mjetet. Unë këtu e kam dhënë një propozim 50.000€, por me dëshirë e kisha bë edhe 100.000€. Njëjtë është edhe DKA-ja për shkak të kontratës kolektive dhe tani jemi shumë në deficit buxhetor. Me dëshirë e kisha rritë edhe projektin që e përmende, edhe pse nuk është keq i buxhetuar, sepse i njëjti projekt në vitin 2026 do të qëndrojë mirë, nëse eventualisht nuk na "gjuhet" thesari përsëri. Me një fjalë, ky vit do të jetë vit i vështirë financiar.

Berat Duraku: Drejtor, e pashë që e keni planifikuar ta hapni një kod të ri për sistem të ujitjes. Tani, nëse ata nuk të kanë lejuar të hapësh kod të ri, a ka mundësi që të njëjtat mjete të barten në kategorinë e subvencioneve? Të propozohet në seancën të kuvendit dhe prej subvencioneve ta zbatoni projektin për sistem të ujitjes.

Afrim Limani: Do ta kem parasysh!

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e tetë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026:

Skender Hamza: Të nderuar kuvendarë, plani i punës së KKSB-së është përgatitur nga kryetari i komunës, së kryesues këtij këshilli si dhe nga unë në rolin e koordinatorit të KKSB-së. Ky plan është aprovuar në mbledhjen e KKSB-së më 3 mars 2026. Pas aprovimit në KKSB, ky plan duhet të aprovohet edhe në kuvend.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender! Atëherë, po e vendosim formalisht në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht miratohet pika e nëntë.

10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qendrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Rahovecit 2026 – 2028:

Lendrit Qeli: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së. Më lejoni ta prezantoj para jush Planin Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve për periudhën 2026-2028. Ky është një plan vazhdimësi e planit të skaduar për viti 2023-2025. Ky plan është hartuar në bazë të strategjive dhe rregulloreve shtetërore për integrimin dhe migrimin. Planit përqëndrohet në disa fusha kryesore: Identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të personave të riatdhesuar, referimin e tyre në shërbimet komunale-institucionale, mbështetje në punësim – mirëqenie sociale dhe arsim, si dhe koordimin ndër-institucional dhe bashkëpunim me donatorët. Është me rëndësi të theksohet se, plani nuk kërkon kosto shtesë nga buxheti komunal, sepse kompetencat janë në nivel qëndror.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Po e hapim diskutimin? Nëse jo, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e dhjetë e rendit të ditës.

14. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025-2026:

Muhamet Morina: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive dhe shumë të respektuar asambleistë anëtarë të KPF-së. Para jush e keni materialin, në të cilin është pasqyruar kronologjikisht ecuria e mësimdhënies dhe procesit mësimor në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Rahovecit. Nuk jam shumë kompetent që të jap informacione për këtë pjesë të kohës, megjithatë jam interesuar për informacione. Do të dëshiroja që pyetjet tuaja të orientohen në këtë pjesën që njëmend e kam marrë me seriozitet dhe po përpiqem në maksimum ta bëj punën mirë. Materialin që e keni përpara është i strukturuar në tri shtylla rreth punës që është bërë në gjysmëvjetorin e parë 2025-2026: Shtylla e parë ka të bëjë me përgatitjen infrastrukurore të objekteve shkollore. Shtylla e dytë: Regjistrimin i nxënësve në klasa të para dhe në të dhjetat, si dhe plotësimi i normave ekzistuese me personel të kualifikuar. Të gjitha statistikave i keni të paraqitura në formë tabelare dhe në fund jam munduar që ta paraqes gjendjen në fund të gjysmëvjetorit të parë, ku në çerdhe në parafillor kemi pasur 879 nxënës. Nga klasa e parë deri në të nëntën 5143 nxënës dhe nga klasat e 10-ta deri në të 12-tën 996 nxënës. Totali është 7018 nxënës.

Lirigzon Kastrati: Kontributin për këtë informatë do ta japim në mbledhjen e rregullt. Pyetje është rreth numrit të nxënësve në krahasim me vitin paraprak?

Muhamet Morina: Numri i nxënësve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore është duke u zvogëluar, bile me trend goxha të theksuar. Jemi duke u përpjekur rreth planifikimit të normave të mësimdhënësve dhe shpresoj që në në vitin shkollor në shtator, do të jenë të gjitha të rregulluara ashtu siç kërkohet me udhëzim administrativ. Një statistikë të vogël: E ka marrë një shkollë urbane “Isa Boletini” dhe një rurale të thellë, si dhe një shkollë gjysëm-urbane. Këtu e kam parë trendin e rënies së numrit të nxënësve nga paslufta. Fakti është tmerrues. Në shkollat rurale rënie ka qenë deri në 65%. Shkolla “Isa Boletini” fatmirësisht i ka vetëm 19,5% rënie, prej pasluftës deri sot. Unë mendoj që, këtu një indikator mund të jetë i saktë. Shkolla “Isa Boletini” njihet për cilësi të mirët e mësimit dhe mund të ketë në qytet lëvizje nga shkollat e tjera në shkollën “Isa Boletini” dhe kjo mund të jetë arsye që nuk ka rënie në numër të nxënësve.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, unë kam diçka blic rreth kësaj informate. Në faqen numër 1 shkruan: “është planifikuar”, duket të jetë “janë regjistruar”. Në tabelarin e dytë, 2.1 te gjinnazi “Xhelal Hajda - Toni” është një gabim teknik, nuk janë 9 paralele, por janë 6. Në faqen nr. 4 është irelevante ora e mbledhjeve, te fjalia e fundit, e cila thotë: “Po ashtu, duke filluar nga ora 13:00 në sallën e KK- Rahovec është mbajtur takimi me drejtorë të shkollave dhe koordinatorë shkollorë për sigurimin e cilësisë, ku janë diskutuar çështjet me rëndësi për funksionimin dhe përmirësimin e procesit mësimor dhe administrativ”. Kjo është krejt irelevante për një informatë. Unë gjithashtu që po e lexoj, po i nxjerri telashe këtyre që e shkruajnë procesverbalin. Në faqen 5, pika e fundit: “Sipas të dhënave të regjistrimit, statistikave për numër të nxënësve”. Kjo është shumë mirë për çerdhe, parafillor, për klasat 1-9 dhe nga klasa 10-12, por kjo duhet të pasurohet me informatën se sa mësimdhënës janë dhe staf administrativ. Ne e kemi diskutuar edhe në seancën e kuvendit komunal, ku drejtori në faqen e facebook-ut ka shkruar rreth mungesës së kuadrit profesional në shkolla dhe jemi marrë vesh që në këtë informatë të jetë edhe kjo informatë, apo edhe si pikë e veçantë e rendit të ditës. Në këtë informatë, gjithashtu të përfshihen edhe mungesat e nxënësve, mungesat e arsimtarëve, profesorëve, edukatorëve etj. A ka sanksionim në paga, sepse disa prej informatave që qarkullojnë ka arsimtarë që nuk vinë hiç në mësim dhe tutje mund ta shohim edhe kualitetin e mësimdhënies. Cili është sanksionimi i drejtorisë ndaj këtyre arsimtarëve? Në informatë të përfshihen garat dhe olimpiadat e mundshme, transporti. Si informatë duhet të tregojmë që transporti është falas. Sa arsimtarë i kemi me kontrata të përkohshme? Kam edhe shumë pyetje, por këtu po ndalem. Drejtor, e di që ti nuk ke qenë për këtë periudhë kohore, por është përgjegjësi e institucionit. Përndryshe, të përgëzoj për punën dhe angazhimin që po e bën.

Muhamet Morina: Faleminderit, kryesues! I shënova disa nga vërejtjet e juaja dhe janë vërejtje cilësore. Kjo informatë nuk është kompetencë e imja, është material që është përgatitur nga drejtori i kaluar. Unë do ta pasuroj me informacione dhe për mbledhjen e radhës do ta keni të kompetuar, me informata rreth këtyre shqetësimeve të kryesuesit. Sa i përket mungesës së mësimdhënësve të shkencave, unë jam prononuar. Shkrimin tim e kam pasuruar edhe me elemente të tjera dhe si drejtor i ri, nuk e di si do të shkon kjo punë. Kërkoj nga ju të më informoni se si duhet të veprojmë. Nëse dëshirojmë që problematikën e mungesës së mësimdhënësve ta zbusim dhe ta amortizojmë, ndoshta do të ishte mirë që mësimdhënësve aktualë t'ju shtojmë edhe 4-5 orë shtesë si normë dhe të zëvendësohen vendet vakante me mësimdhënës profesionistë. Për këtë çështje, në javën që vjen (të martën) kam takim me dekanët e dy fakulteteve Filozofik dhe Pedagogjik, për plotësimin e mungesës së pedagogëve dhe psikologëve në shkollat tona me studentë absolventë, të cilët mund të kryejnë praktikë profesionale dhe ta këtë ta shfrytëzojnë për hulumtime në shkollat tona.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Ashtu siç ta shihni të arsyeshme. Nëse ju mendoni që informatën mund ta përgatitni për seancë të kuvendit, atëherë ne mund ta bëjmë si pikë të veçantë informatën e DKA-së.

Lirigzon Kastrati: Pajtohem që në raport duhet të përfshihen edhe informatat e potencuara nga ju. Në seancën e kaluar e kam kërkuar informatën rreth mungesës së kuadrit profesional. Meqenëse është një shqetësim, kërkoj që kjo temë të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës dhe bashkërisht në kuvend ta diskutojmë këtë pikë.

Berat Duraku: E falënderoj drejtorin për përgatitjen e kësaj informate. Unë propozoj të kundërtën e kolegut dhe si pjesë e informatës që është pikë e rendit të ditës të shtohet edhe pjesa e shqetësimit për deficitin e kuadrit profesional.

Muhamet Morina: Në mbledhjen e kaluar, asambleisti Lirigzon Kastrati i bëri disa pyetje dhe unë isha i gatshëm t'i përgjigjesha dhe e diskutuam më pas. Lirigzon, për pyetje tuaja do të përgjigjem detajisht në seancën e rregullt të kuvendit.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Propozoj që brenda informatës të përfshihet edhe kjo çështje e kuadrit deficitar. Drejtor, besoj që sekretaria e kuvendit të hënën e dërgon materialin për kuvend, por edhe nëse nuk arrin ta kompetosh materialin të hënën, ka kohë të martën e të mërkurën, si dhe të mërkurën. Është e nevojshme që informata të jetë gati 2-3 ditë para seancës.

12. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2025:

Enise Dina: Përshëndetje për të gjithë! Në mungesë të zyrtarit përgjegjës të prokurimit, po e prezantoj unë planin vjetor të aktiviteteve të prokurimit. I kemi zhvilluar 45 aktivitete të prokurimit, me vlerë të parashikuar 15.497.319€. Kontrata gjithsej janë nënshkruar 40 për punë, furnizime e shërbime. Vlera e kontratave: 15.157.606€. Për të gjitha pyetjet dhe paqartësitë, ju lutem që t'i bëni në seancën e rregullt, meqenëse shefi i prokurimit nuk është i pranishëm.

13. Të ndryshme:

Kryesuesi: A ka dikush të shtojë diçka rreth pikës së fundit të rendit të ditës? Nëse jo, atëherë më lejoni t'ju informoj që për seancën e kuvendit do t'i kemi edhe 5 pika shtesë: 1. Draft-rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për shërbime publike, 01 Nr. 2917, e datës 26.10.2018; 2. Vendimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës dhe objektit të sheshi qendror; 3. Vendimi për caktimin e komisionit për dhënie të pronës në shfrytëzim afatgjatë; 4. Formimimi i komitetit joobligativ për Shërbime Publike; 5. Formimimi i komitetit joobligativ për Emergjencë. Në fund, ju informoj që do të jetë një vizitë studimore prej dy bashkive, më datë 26 mars, nga Mallakastra dhe Mirdita. Kuvendarët e këtyre dy bashkive do të vinë për vizitë te ne dhe ju ftoj juve që keni kohë, së paku anëtarët e KPF-së, të bashkoheni dhe t'i mirëpresim vëllezërit tanë nga Shqipëria. Faleminderit, shihemi në seancën e rregullt.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi



KRYESUESI

Fatmir Iska